



## Shkolla Virtuale Barnet

Ärsimi për moshat mbi 16  
vjeç në Mbretërinë e

## Hyrje

Mirë se erdhët në Mbretërinë e Bashkuar!

Qëllimi i kësaj broshure është t'ju japë informacion se si të keni akses në arsim dhe mësim dhe t'ju japë një ide për rrugët e ndryshme që mund të ndiqni.

Sistemi ynë arsimor mund të duket paksa i komplikuar dhe shpresojmë që ky udhëzues t'ju ndihmojë të kuptoni se si funksionon gjithçka.



## Përmbajtja

Udhëzimi është hartuar me shtatë seksionet e mëposhtme:

1. Pasqyra e sistemit arsimor
2. Shembull i rrugës arsimore për moshat mbi 16 vjeç
3. Të rriturit kryesorë të përfshirë në edukimin tuaj
4. Mundësitë në kolegji
5. Kalendari i vitit akademik 21/22
6. Shembull i programit të kolegjit
7. Lidhje dhe kontakte të dobishme

## 1. Pasqyra e sistemit arsimor

### Mirë se erdhët!

Me të mbërritur në këtë vend, do të mbështeteni për t'u regjistruar në një kolegji lokal pranë shtëpisë suaj. Kurset e kolegjit zakonisht fillojnë në shtator dhe përfundojnë në korrik. Kursi i parë që do të kryeni është Anglishtja për folësit e gjuhëve të tjera ose shkurt ESOL (English for Speakers of Other Languages). Këto kurse ESOL janë fleksibël, kështu që mund të filloni edhe pas shtatorit, për shembull në janar.



... kursi i parë që do të kryeni është Anglishtja për folësit e gjuhëve të tjera ose shkurt ESOL ...

Kur të regjistroheni në kolegjin tuaj lokal, do të vlerësohen aftësitë tuaja në anglisht dhe matematikë. Në varësi të nivelit tuaj në anglisht dhe matematikë, do të caktoheni në 1 nga 4 nivelet ESOL. Në një kurs ESOL ju do të studioni anglisht (Të dëgjuarit dhe të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit), matematikën dhe Teknologjinë Kompjuterike të Informacionit (ICT-Information Computer Technology). Do t'ju jepet mundësia të fitoni eksperiencë pune ose të merreni me aktivitete të tjera.

Një tipar thelbësor i kursit ESOL është fleksibiliteti, pasi një student mund të lëvizë nga Niveli Hyrje 1 në nivelin e hyrjes 2 brenda një viti akademik (shtator – korrik). Në kurset e zakonshme kjo nuk do të ishte e mundur. Ngjitja e studentit ESOL në nivele brenda vitit varet nga angazhimi i studentit dhe niveli i punës së kryer.

Pas Nivelit të hyrjes 3 të ESOL, mund të filloni një kurs profesional ose të zakonshëm, për shembull për instalime elektrike, pajisje hidraulike, studime mediatike, ndërtim dhe shumë e shumë të tjera.

# Shkolla Virtuale Barnet

Kurset që ofrohen ndryshojnë për kolegje të ndryshme dhe ju do të keni mundësinë të zgjidhni kursin që dëshironi!


Ju mund të kryeni edhe nivelin 1 të ESOL që është edhe niveli më i lartë i ESOL dhe do t'ju aftësojë për të qenë gati të bëni një kurs profesional.

Në nivelin e hyrjes 3 të ESOL, tutori/mësuesi juaj i kolegjit do t'ju këshillojë për hapat e ardhshëm dhe do t'ju ndihmojë të zgjidhni kursin që dëshironi.

## **Pas ESOL**

Pas ESOL, kur bëni kurse profesionale/të zakonshme do të vazhdoni të studioni matematikë dhe anglisht.

Kjo do të zhvillohet në mënyrën e mëposhtme:



Studimi për marrjen e Certifikatës së Përgjithshme të Arsimit Sekondar për Matematikë dhe Anglisht kërkon mesatarisht rreth 5-6 vite punë.


Pas marrjes së kualifikimit të Aftësive Funksionale Niveli 1 dhe 2 për Anglisht dhe Matematikë, mund të merrni në konsideratë edhe kryerjen e praktikës pas studimeve. Ky është një kualifikim gjatë të cilit do të punoni dhe studioni.

## **Takimet e Planit të Arsimit Personal (PEP-Personal Education Plan)**

Kur të jeni nën kujdesin e Planit të Arsimit Personal, do të zhvillohet një takim për t'ju mbështetur në rrugën tuaj arsimore. Këto takime të PEP-it mbahen 3 herë në një vit akademik për t'u siguruar që po ecni mirë në kolegji dhe për t'ju dhënë mundësinë të bëni pyetje, për të parë nëse keni nevojë për më shumë mbështetje dhe për të dhënë mendimet tuaja se si po shkon kolegji.

## 2. Shembull i Rrugës Arsimore për moshat mbi 16 vjeç


Më poshtë mund të shihni një shembull të rrugës arsimore që mund të ndiqni:



# Shkolla Virtuale Barnet

## 3. Personat madhorë kryesorë të përfshirë në edukimin tuaj

Ka shumë persona madhorë të përfshirë në edukimin tuaj për t'ju mbështetur:



### Roli i Punonjësit Social/Këshilluesit Personal

Punonjësi Social është një person që punon për një autoritet vendor/departament të këshillit të quajtur Shërbime Sociale. Roli i tij është të sigurohet që fëmijët (të gjithë personat nën 18 vjeç në MB) kanë kujdesin e duhur kur ata nuk kanë ku të jetojnë dhe kur prindërit e tyre nuk janë të pranishëm ose nuk mund të kujdesen për ta. Punonjësi juaj social do të organizojë takime të Planit Arsimor për Nxënësit (PEP) 3 herë gjatë një viti akademik me kolegjin/shkollën, për t'u siguruar që arsimimi juaj po shkon mirë dhe ju keni mundësinë të ngrini çdo shqetësim apo problem. Një këshillues personal gjithashtu punon për shërbimet sociale dhe ju mbështet pas moshës 18 vjeç.

### Kujdestari juaj

Kujdestari juaj është personi me të cilin jetoni çdo ditë. Ai do t'ju mbështes për kujdesin tuaj të përditshëm së bashku me punonjësin tuaj social, p.sh., do t'ju çojë në takime me avokatë, mjekë, shkollë/kolegj etj. Nëse ju duhet urgjentisht të bëni pyetje rreth arsimit, mund të pyesni kujdestarin tuaj i cili mund t'ju ndihmojë ose mund të marrë informacion nga profesionistë të tjerë.

### Roli i Tutorit/Mësuesit

# Shkolla Virtuale Barnet

Tutori/mësuesi është personi që do t'ju japë mësimet ESOL çdo ditë në kolegjin. Tutori/mësuesi do të jetë personi kryesor që do të shikoni më shpesh në kolegjin dhe do t'ju ndihmojë të kaloni provimet dhe të përparoni në nivelet ESOL.

## Roli i mësuesit të caktuar

Roli i mësuesit të caktuar është promovimi i arritjeve arsimore të të gjithë Fëmijëve nën Kujdes (ti) që janë në shkollën/kolegjin e tyre. Ata janë përgjegjës për të siguruar plotësimin e nevojave tuaja arsimore, që ju të merrni mbështetjen e duhur për të bërë më të mirën që mundeni dhe që zëri juaj të dëgjohet në shkollë ose kolegjin. Mësuesi i caktuar duhet të:

**Promovojë një kulturë të pritshmërive dhe aspiratave të larta për Fëmijët nën Kujdes**

**Sigurojë që zëri juaj të dëgjohet në kolegjin**

**Sigurojë ofrimin dhe mbështetjen e cilësisë së lartë për të gjithë Fëmijët nën Kujdes në kolegjin/shkollën e tyre**

**Sigurohet që nevojat e Fëmijëve nën Kujdes të kenë përparësi**

**Veprojë si burim këshillimi dhe udhëzimi për të rinjtë dhe personelin**

**Zhvillojë takime të Planit Arsimor për Nxënësit (PEP) për të mbajtur shënim se si po ecni në kolegjin/shkollë**

## Roli i Shkollës Virtuale Barnet

Ju do të keni mbështetjen e një punonjësi social të Shkollës Virtuale. Krahas pjesëmarrjes në takimet e PEP dhe mbështetjes ndaj jush në aspektin e arsimit, ky punonjës social do të:

**Sigurohet që kolegji/shkolla juaj të kuptojë se si t'ju ndihmojë të përparoni dhe të arrini qëllimet tuaja në arsim**


**Organizojë ndonjëherë ndihmë shtesë për t'ju mbështetur, si p.sh. kurse shtesë të anglishtes**

**Japë këshilla dhe udhëzime për studimet dhe planet tuaja për të ardhmen**

**Sigurojë një laptop për t'ju mbështetur në mësimin në shtëpi përmes Internetit**

## 4. Mundësitë në kolegji

Ka shumë mundësi në kolegji të cilat mund të aksesohen. Këtu paraqiten disa prej tyre:



**Sporte** - Në kolegji zakonisht mund të futeni në ekipet sportive dhe të përdorni palestrën!




**Biblioteka** – Në kolegje ka pothuajse gjithmonë biblioteka, ku mund të merrni libra për të lexuar për argëtim ose që t'ju ndihmojnë me studimin!



**Bursa** – Pothuajse çdo kolegji u ofron studentëve një bursë (rreth 30 sterlina në javë). Për ta fituar atë studentët duhet të kenë frekuentim të lartë!

Kjo zakonisht kërkon një llogari bankare, kështu që, në marrjen e bursës në fillim mund të ketë probleme, por ato zakonisht zgjidhen.



**Këshilla për karrierën** – Nëse nuk jeni të sigurt se çfarë të bëni në të ardhmen, çdo kolegji ka punonjës udhërrëfyes për karrierë për t'ju ndihmuar të planifikoni.



## 5. Kalendar i vitit akademik

### Viti akademik në Mbretërinë e Bashkuar

Viti akademik, në të cilin zhvillohen përgjithësisht mësimi dhe arsimit në Mbretërinë e Bashkuar, zgjat nga shtatori në korrik. Gjatë vitit do të keni ndërprerje të programit mësimor dhe pushime në periudha të ndryshme:

### **Semestri i vjeshtës 2021 (periudha e parë mësimore e vitit)**

| Semestri i vjeshtës 2021             | Datat  |
|--------------------------------------|--|
| Periudha e parë (fillimi i shkollës) | Nga dita e mërkurë, 01 shtator, deri të premten,, 22 tetor |
| MesSemestri (Pushime!)               | Nga dita e hënë, 25 tetor, deri të premten,, 29 tetor      |
| Periudha e dytë                      | Nga dita e hënë, 01 nëntor, deri të premten,, 17 dhjetor   |
| Pushime shkollore                    | Nga dita e hënë, 20 dhjetor deri të hënë 03 janar          |

### **Semestri pranveror 2022**

| Semestri pranveror 2022 | Datat  |
|-------------------------|--|
| Periudha e parë         | Nga dita e martë, 04 janar deri të premten,, 11 shkurt                               |
| Mes Semestri (Pushime!) | Nga dita e hënë, 14 shkurt deri të premten, 18 shkurt                                |
| Periudha e dytë         | Nga dita e hënë, 21 shkurt deri të premten, 01 prill                                 |
| Pushime shkollore       | Nga dita e hënë, 04 prill deri të hënë, 18 prill (fundjava e Pashkëve 15 - 18 prill) |

### **Semestri veror 2022 (Periudha e fundit mësimore e vitit!)**

| Semestri veror 2022     | Datat  |
|-------------------------|--|
| Periudha e parë         | Nga dita e martë, 19 prill, deri të premten, 27 maj (Ditë feste e majit më 02 maj)   |
| Mes Semestri (Pushime!) | Nga dita e hënë, 30 maj deri të premten, 03 qershor (Festa e Pranverës do të jetë më 02 qershor, me një ditë feste shtesë më 03 qershor) |
| Periudha e dytë         | Nga dita e hënë, 06 qershor deri të premten, 22 korrik   |
| Pushime shkollore       | Nga dita e hënë, 25 korrik deri të enjten 01 shtator   |

## 6. Shembull i programit të kolegjit

Në foton më poshtë është një shembull i programit të kolegjit i cili tregon se si do të përcaktohen ditët tuaja të mësimit. Shumica e kolegjeve do t'ju kërkojnë të studioni katër ditë në javë:

Timetable for 3A1002 (21G11) - Weeks 1-52

|           | 09:00 | 10:00                | 11:00   | 12:00 | 13:00   | 14:00   | 15:00   | 16:00 | 17:00 |
|-----------|-------|----------------------|---------|-------|---------|---------|---------|-------|-------|
| Monday    |       |                      |         |       |         |         |         |       |       |
| Tuesday   |       | English              | English |       | English |         | English |       |       |
| Wednesday |       | Maths                |         |       | Maths   | Maths   |         |       |       |
| Thursday  |       | English              | English |       |         | ICT     |         |       |       |
| Friday    |       | Personal Development |         |       | English | English | English |       |       |
| Saturday  |       |                      |         |       |         |         |         |       |       |
| Sunday    |       |                      |         |       |         |         |         |       |       |

## 7. Lidhje të dobishme

### Kontakte të dobishme

Shkolla Virtuale Barnet

[Barnet.virtualschool@barnet.gov.uk](mailto:Barnet.virtualschool@barnet.gov.uk)

0208 359 4534

Portali për qytetarët e rinj, Shërbimi Barnet për Refugjatët - New Citizens' Gateway (Barnet Refugee Service)  
[Portali për qytetarët e rinj, Shërbimi Barnet për Refugjatët - New Citizens' Gateway \(Barnet Refugee Service\) \(ncgateway.org.uk\)](http://ncgateway.org.uk)

[info@ncgateway.org.uk](mailto:info@ncgateway.org.uk)

07983 437 425

Këshilli i Refugjatëve (Refugee Council)

<https://www.refugeecouncil.org.uk>

[info@refugeecouncil.org.uk](mailto:info@refugeecouncil.org.uk)

02073466700

### Lidhje të dobishme për mësim dhe informacion

<https://elt.oup.com/student/headway/?cc=gb&sellLanguage=en>

Headway English Online – Resurse nga fillestare në të avancuara duke përfshirë gramatikën, fjalorin, anglishten e përditshme dhe teste.

<https://www.britishcouncil.org/school-resources/find>

Kurs online me një test anglisht falas për të ndihmuar vlerësimin e nivelit. Materiale dëgjimi dhe leximi dhe seksione gramatike dhe fjalori. Veçanërisht të dobishme në rastin e kishave të Bashkuara Metodiste për ata që e kanë anglishten gjuhë shtesë.

<https://www.perfect-english-grammar.com>

Kurse për gramatikë të sjkëlqyer të gjuhës angleze që mbulojnë të gjitha aspektet.

<https://www.gamestolearnenglish.com>

Kjo është një faqe falas për studentët për të mësuar anglisht online. Ekziston një përzgjedhje lojërash që studentët mund t'i përdorin për të praktikuar mësimin e anglishtes në mënyrë argëtuese.

[Free English Classes for Refugees | Conversation Over Borders](#)

Conversation Over Borders lidh azilkërkuesit dhe refugjatët me tutorët vullnetarë për kurse bisedash një-me-një falas në anglisht. Kjo lidh kufijtë përmes lidhjes njerëzore duke ndihmuar në ndërtimin e besimit në të folurit anglisht.

[Right to Remain - Asylum Journey \(youngasylumguide.org.uk\)](http://youngasylumguide.org.uk)

Një udhëzues i dobishëm për rrugën e azilit